

VENDIM
Nr. 970, datë 26.10.2015

**PËR DHËNIEN E MANDATIT TË DEPUTETIT TË KUVENDIT KANDIDATIT
TË LISTËS SHUMEMËRORE TË PARTISË SOCIALISTE NË QARKUN LEZHË,
PËR PLOTËSIMIN E VAKANCËS SË NJOFTUAR NGA KUVENDI I SHQIPËRISË**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 26.10.2015, me pjesëmarrjen e:

Lefterije	Luzi	kryetare
Denar	Biba	zëvendëskryetar
Edlira	Jorgaqi	anëtare
Gëzim	Veleshnja	anëtar
Hysen	Osmanaj	anëtar
Klement	Zguri	anëtar
Vera	Shtjefni	anëtare

Shqyrtoi çështjen me

Objekt: Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit kandidatit të listës shumemërore të Partisë Socialiste, në Qarkun e Lezhës, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë pas heqjes dorë nga mandati i deputetit të z. Arben Ndoka.

Kërkesë: Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

Baza ligjore: Neni 4 dhe 69 pika 1, germa “d” i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neni 23, pika 1, germa “a”, neni 164, pika 2, i ligjit nr 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

KQZ, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoi diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

VËREN:

Nëpërmjet shkresës nr. 7820 prot., datë 22.10.2015, drejtuar KQZ-së, Sekretari Përgjithshëm i Kuvendit, znj. Albana Shtylla, njofton krijimin e vakancës për shkak të heqjes dorë nga mandati i deputetit të Kuvendit të Shqipërisë të z. Arben Ndoka, deputet i zonës zgjedhore, Qarku Lezhë.

Neni 164 i Kodit Zgjedhor përcakton se, në rast të ndërprerjes së mandatit të deputetit, Kuvendi njofton KQZ-në për krijimin e vakancës dhe KQZ-ja merr vendim për dhënien e mandatit kandidatit të radhës në listën shumemërore të së njëjtës parti politike në zonën zgjedhore përkatëse, regjistruar sipas nenit 67 të Kodit Zgjedhor.

Kolegji Zgjedhor, me vendimin nr. 35, datë 2.8.2013 ka shpërndarë mandatet dhe ka përcaktuar kandidatët fitues për zonën zgjedhore Qarku Lezhë, në zgjedhjet për Kuvendin të vitit 2013. Sipas vendimit të sipërcituar, Partia Socialiste për zonën zgjedhore Qarku Lezhë për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 23 Qershor 2013 ka fituar 2 mandate dhe kandidatët fitues nga lista shumemërore e Partisë Socialiste për Qarkun e Lezhës, janë si më poshtë: me numër rendor 1 (një) Mimi Pjetër Kodheli, me numër rendor 2 (dy) Armando Ndue Prenga.

Pas njoftimit nga Kuvendi për krijimin e vakancave të njëpasnjëshme, për shkak të heqjes dorë nga mandati i deputetit të Kuvendit të Shqipërisë të Zj. Mimi Kodheli, zj. Mejreme Delishi¹, zj. Mirela Neli² deputete të zonës zgjedhore Qarku Lezhë, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me vendimin 5, datë 28.01.2014 i ka dhënë mandatin e deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë z. Arben Ndoka.

KQZ-ja me vendimin nr. 337, datë 11.5.2013 “Për miratimin e listave shumemërore të Partisë Socialiste, pjesëtare e koalicionit “Aleanca për Shqipërinë Europiane” për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë 2013”, ka miratuar listën shumemërore të Partisë Socialiste për 12 zonat zgjedhore.

Rezulton se lista shumemërore e Partisë Socialiste në Qarkun Lezhë i plotëson të gjitha kriteret e

¹Zj. Mejreme Delishi ka qenë kandidate me nr. rendor 5 (pesë) në listën shumemërore të kandidatëve për deputet të Partisë Socialiste, qarku Lezhë.

² Zj. Mirela Neli ka qenë kandidate me nr. rendor 8 (tetë) në listën shumemërore të kandidatëve për deputet të Partisë Socialiste, qarku Lezhë.

përcaktuara në nenin 67, të Kodit Zgjedhor, duke përfshirë dhe kriterin e gjinisë. Në këto kushte zëvendësimi i vakancës do të bëhet sipas përcaktimeve të nenit 164, pika 2 të Kodit Zgjedhor.

Sipas listës shumemërore të kandidatëve për deputet për zonën zgjedhore Qarku Lezhë, të Partisë Socialiste, rezulton se pas Z. Arben Ndoka kandidati i radhës është me numër rendor 4 (katër) z. Ndrec Ndue Dedaj.

Referuar vendimit të KQZ-së nr. 965, datë 10.8.2015, “Për shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të vitit 2015”, rezulton se KQZ ndër të tjera ka shpallur rezultatin e votimit për Kryetar, Bashkia Mirditë duke shpallur fitues z. Ndrec Ndue Dedaj.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, në nenin, 69, pika 1, germa “d” të saj dhe nenin 63, pika 4, germa “d” i Kodit Zgjedhor kanë përcaktuar se “nuk mund të kandidojnë dhe as të zgjidhen pa hequr dorë më parë nga detyra..... kryetarët e bashkive apo komunave.....”

Z. Ndrec Ndue Dedaj, me shkresën nr. 7830, datë 23.10.2015 ka lëshuar një deklaratë noteriale, ku deklaron se me vullnet të plotë refuzon të heq dorë nga detyra e kryetarit të bashkisë Mirditë, për t’u zgjedhur deputet në Kuvendin e Shqipërisë.

Sipas dispozitave të sipërpërmendura, rezulton se z. Ndrec Ndue Dedaj, kandidati i radhës në listën shumemërore të Partisë Socialiste, qarku Lezhë, pas z. Arben Ndoka, është në kushtet e pazgjidhshmërisë si deputet në Kuvendin e Shqipërisë, për shkak të zotërimit të mandatit të kryetarit të Bashkisë Mirditë, funksion nga i cili nuk do të dorëhiqet, për tu zgjedhur deputet.

Në këto kushte, duke qenë se kandidati i radhës, z. Ndrec Dedaj nuk mund të zgjidhet si deputet, mandati i ndërprerë i z. Arben Ndokaj do t’i kalojë kandidatit të radhës nga lista shumemërore e kandidatëve për deputet të Partisë Socialiste, Qarku Lezhë, pas z. Ndrec Ndue Dedaj.

Për sa më sipër mandati i ndërprerë i kalon kandidatit vijues me nr. rendor 6 (gjashtë) Z. Eduart Mark Ndocaj, sipas listës shumemërore për zonën zgjedhore, qarku Lezhë të Partisë Socialiste.

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, mbështetur në nenin 23, pika 1, germa “a” dhe nenin 164, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

VENDOSI:

1. T’i japë mandatin e deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, kandidatit të radhës në listën shumemërore të Partisë Socialiste Qarku Lezhë, z. Eduart Mark Ndocaj.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor, pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga shpallja e këtij vendimi.